

LIGJ
Nr. 113/2024

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN OPSIONAL
TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE
DHE KULTURORE, BËRË NË NJU-JORK, NË DATËN 10.12.2008**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Opsional të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, bërë në Nju-Jork, në datën 10.12.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.11.2024.

Shpallur me dekreten nr. 400, datë 6.12.2024 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën A/RES/63/117, më 10 dhjetor 2008

Protokolli Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Asambleja e Përgjithshme,

Duke marrë parasysh miratimin nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut, me Rezolutën 8/2, të datës 18 qershor 2008, të Protokollit Opsional të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore:

1. *Miraton* Protokollin Opsional të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, teksti i të cilit i bashkëlidhet kësaj rezolute.

2. *Rekomandon* që Protokolli Opsional të hapet për nënshkrim në një ceremoni nënshkrimi që do të mbahet në vitin 2009 dhe i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut që të ofrojnë ndihmën e nevojshme.

SHTOJCË
PROTOKOLLI OPSIONAL I PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT
EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

Preambula

Shtetet Palë të këtij protokolli,

Duke pasur parasysh se në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe e të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.

Duke theksuar se Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut shpall se të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta dhe se secili ka të drejtë për të gjitha të drejtat dhe liritë e përcaktuara në të, pa asnjë dallim, si: raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinionimi politik ose opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, pasuria, lindja ose status tjetër,

Duke rikujtuar se Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut pranojnë se ideali i qenieve njerëzore të lira që gëzojnë lirinë nga frika dhe mungesa, mund të arrihet vetëm nëse krijohen kushte ku të gjithë mund të gëzojnë të drejta civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.

Duke riafirmuar universalitetin, pandashmërinë, ndërvlerësinë dhe ndërlidhjen e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,

Duke rikujtuar se çdo Shtet Palë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (në vijim i referuar si “Pakti”) merr përsipër të ndërmarrë hapa, individualisht dhe nëpërmjet asistencës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht ekonomik dhe teknik, në maksimumin e burimeve të disponueshme, me synimin për të arritur në mënyrë progresive realizimin e plotë të të drejtave të njohura në Pakt me të gjitha mjetet e duhura, duke përfshirë veçanërisht miratimin e masave legjislative.

Duke marrë parasysh se për të arritur më tej qëllimet e Paktit dhe zbatimin e dispozitave të tij, do të ishte e përshtatshme që Komisionit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (në vijim “Komiteti”) t’i mundësohej kryerja e funksioneve të parashikuara në këtë protokoll,

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Kompetenca e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet

1. Një Shtet Palë i Paktit që bëhet palë e këtij protokollit, njeh kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet, siç parashikohet nga dispozitat e këtij protokollit.

2. Asnjë komunikim nuk do të merret nga Komiteti nëse lidhet me një Shtet Palë të Paktit që nuk është Palë në këtë protokoll.

Neni 2

Komunikimet

Komunikimet mund të dorëzohen nga ose në emër të individëve ose grupeve të individëve, nën juridiksionin e një Shteti Palë, duke pretenduar se janë viktima të shkeljes së cilësdo prej të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të përcaktuara në Pakt nga ai Shtet Palë. Kur një komunikim dorëzohet në emër të individëve ose grupeve të individëve, kjo do të bëhet me pëlqimin e tyre, përveç rastit kur autori mund të justifikojë veprimin në emër të tyre pa një pëlqim të tillë.

Neni 3

Pranueshmëria

1. Komiteti nuk do të shqyrtojë një komunikim nëse nuk ka konstatuar se janë shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme në dispozicion. Ky nuk do të jetë rregull kur zbatimi i mjeteve të tilla zgjatet në mënyrë të paarsyeshme.

2. Komiteti do të deklarojë një komunikim të papranueshëm kur:

a) nuk është dorëzuar brenda një viti pas shterimit të mjeteve të brendshme juridike, me përjashtim të rasteve kur autori mund të provojë se nuk ka qenë e mundur të dorëzohet komunikimi brenda atij afati kohor;

b) faktet që janë objekt i komunikimit, kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij protokollit për Shtetin Palë në fjalë, përveç rasteve kur ato fakte kanë vazhduar pas kësaj date;

c) e njëjta çështje tashmë është shqyrtuar nga Komiteti ose është shqyrtuar ose po shqyrtohet sipas një procedure tjetër të hetimit ose zgjidhjes ndërkombëtare;

d) është i papajtueshëm me dispozitat e Paktit;

- e) është haptazi i pabazuar, jo mjaftueshëm i vërtetuar ose i bazuar ekskluzivisht në raportet e shpërndara nga masmedia;
- f) është shpërdorim i së drejtës për të paraqitur një komunikim; ose kur
- g) është anonim ose jo me shkrim.

Neni 4

Komunikimet që nuk zbulojnë një disavantazh të qartë

Komiteti, nëse është e nevojshme, mund të refuzojë të marrë në konsideratë një komunikim kur nuk zbulon se autori ka pësuar një disavantazh të qartë, përveç rastit kur Komiteti çmon se komunikimi ngre një çështje serioze me rëndësi të përgjithshme.

Neni 5

Masat e përkohshme

1. Në çdo kohë pas marrjes së një komunikimi dhe përpara se të arrihet një vendim mbi themelin, Komiteti mund t'i transmetojë Shtetit Palë në fjalë, për shqyrtim urgjent, një kërkesë që Shteti Palë të marrë masa të përkohshme që mund të jenë të nevojshme në rrethana të jashtëzakonshme, për të shmangur dëmet e mundshme të pariparueshme për viktimën ose viktimat e shkeljeve të supozuara.

2. Kur Komiteti ushtron diskrecionin e tij sipas paragrafit 1 të këtij neni, kjo nuk nënkupton një vendim mbi pranueshmërinë ose themelin e komunikimit.

Neni 6

Transmetimi i komunikimit

1. Me përjashtim të rasteve kur Komiteti e çmon një komunikim të papranueshëm pa iu referuar Shtetit Palë në fjalë, Komiteti do të sjellë çdo komunikim që i paraqitet atij sipas këtij protokoll, në mënyrë konfidenciale, në vëmendjen e Shtetit Palë në fjalë.

2. Brenda gjashtë muajve, Shteti Palë pritës do t'i paraqesë Komitetit shpjegime ose deklarata me shkrim që sqarojnë çështjen dhe mjetin juridik, nëse ka, që mund të jetë dhënë nga ai Shtet Palë.

Neni 7

Zgjidhje miqësore

1. Komiteti do t'u vendosë në dispozicion shërbimet dhe ndihmën e tij palëve të interesuara, me synimin për të arritur një zgjidhje miqësore të çështjes, në bazë të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Pakt.

2. Një marrëveshje për një zgjidhje miqësore mbyll shqyrtimin e komunikimit sipas këtij protokoll.

Neni 8

Shqyrtimi i komunikimeve

1. Komiteti do të shqyrtojë komunikimet e marra sipas nenit 2 të këtij protokoll, duke pasur parasysh të gjithë dokumentacionin e paraqitur, me kusht që ky dokumentacion t'u transmetohet palëve të interesuara.

2. Komiteti do të mbajë mbledhje të mbyllura kur shqyrton komunikimet sipas këtij protokoll.

3. Kur shqyrton një komunikim sipas këtij protokoll, Komiteti mund të konsultojë, sipas rastit, dokumentacionin përkatës që buron nga organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, agjenci të specializuara, fonde, programe dhe mekanizma dhe organizata të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë nga sistemet rajonale të të drejtave të njeriut, dhe çdo vëzhgim ose koment nga shteti palë në fjalë.

4. Kur shqyrton komunikimet sipas këtij protokoll, Komiteti do të marrë parasysh arsyeshmërinë e hapave të ndërmarrë nga Shteti Palë në përputhje me pjesën II të Paktit. Duke vepruar në këtë mënyrë,

Komiteti do të ketë parasysh se Shteti Palë mund të miratojë një sërë masash të mundshme politike për zbatimin e të drejtave të përcaktuara në Pakt.

Neni 9

Vazhdimi i pikëpamjeve të Komitetit

1. Pas shqyrtimit të një komunikimi, Komiteti do t'ua përcjellë palëve të interesuara pikëpamjet e tij mbi komunikimin, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka.

2. Shteti Palë do t'i kushtojë vëmendjen e duhur pikëpamjeve të Komitetit, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, dhe do t'i paraqesë Komitetit, brenda gjashtë muajve, një përgjigje me shkrim, duke përfshirë informacionin për çdo veprim të ndërmarrë, duke pasur parasysh pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit.

3. Komiteti mund të ftojë Shtetin Palë që të paraqesë informacion të mëtijshëm në lidhje me çdo masë që shteti palë ka marrë në përgjigje të pikëpamjeve ose rekomandimeve të tij, nëse ka, duke përfshirë, siç çmohet e përshtatshme nga Komiteti, në raportet e mëvonshme të Shtetit Palë sipas neneve 16 dhe 17 të Paktit.

Neni 10

Komunikimet ndërshtetërore

1. Një Shtet Palë i këtij protokoll mund të deklarojë në çdo kohë, sipas këtij neni, se njeh kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet në kuptimin që një Shtet Palë pretendon se një Shtet tjetër Palë nuk po përmbush detyrimet e tij sipas Paktit. Komunikimet sipas këtij neni mund të merren dhe të shqyrtohen vetëm nëse dorëzohen nga një Shtet Palë që ka bërë një deklaratë që njeh në lidhje me vete kompetencën e Komitetit. Asnjë komunikim nuk do të merret nga Komiteti nëse ka të bëjë me një shtet palë që nuk e ka bërë një deklaratë të tillë. Komunikimet e marra sipas këtij neni do të trajtohen në përputhje me procedurën e mëposhtme:

a) Nëse një Shtet Palë e këtij protokoll konsideron se një Shtet tjetër Palë nuk po i përmbush detyrimet e tij sipas Paktit, ai, me anë të komunikimit me shkrim, mund t'ia sjellë çështjen në vëmendje atij Shteti Palë. Shteti Palë mund të informojë gjithashtu Komitetin për këtë çështje. Brenda tre muajve pas marrjes së komunikimit, shteti pritës do t'i japë shtetit që ka dërguar komunikimin një shpjegim, ose çdo deklaratë tjetër me shkrim që sqaron çështjen, e cila duhet të përfshijë, për aq sa është e mundur dhe me vend, referencë në procedurat dhe mjetet juridike të brendshme. marrë, në pritje ose në dispozicion në këtë çështje;

b) Nëse çështja nuk zgjidhet sipas kërkesave të dy Shteteve Palë të interesuara brenda gjashtë muajve pas marrjes nga shteti pritës të komunikimit fillestar, secili shtet do të ketë të drejtën t'ia referojë çështjen Komitetit, me njoftimin e dhënë për Komitetin dhe shtetin tjetër;

c) Komiteti do të trajtojë një çështje që i referohet atij vetëm pasi të ketë konstatuar se të gjitha mjetet juridike të brendshme të disponueshme janë kërkuar dhe shteruar në këtë çështje. Ky nuk do të jetë rregull kur zbatimi i mjeteve juridike zgjatet në mënyrë të paarsyeshme;

d) Në bazë të dispozitave të nënparagrafit (c) të këtij paragrafi, Komiteti do t'u vendosë në dispozicion shërbimet dhe ndihmën e tij Shteteve Palë të interesuara, me synimin për një zgjidhje miqësore të çështjes në bazë të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Pakt;

e) Komiteti do të mbajë mbledhje të mbyllura kur shqyrton komunikimet sipas këtij neni;

f) Për çdo çështje që i referohet atij në përputhje me nënparagrafin (b) të këtij paragrafi, Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të interesuara, të përmendura në nënparagrafin (b), të japin çdo informacion përkatës;

g) Shtetet Palë të interesuara, të përmendura në nënparagrafin (b) të këtij paragrafi, do të kenë të drejtën të përfaqësohen kur çështja shqyrtohet nga Komiteti dhe të bëjnë parashtrime verbalisht dhe/ose me shkrim;

h) Komiteti, me gjithë përshtatshmërinë e duhur pas datës së marrjes së njoftimit sipas nënparagrafit (b) të këtij paragrafi, do të paraqesë një raport si vijon:

i) Nëse arrihet një zgjidhje brenda kushteve të nënparagrafit (d) të këtij paragrafi, Komiteti do ta kufizojë raportin e tij në një deklaratë të shkurtër të fakteve dhe zgjidhjes së arritur;

j) Nëse nuk arrihet një zgjidhje brenda kushteve të nënparagrafit (d), Komiteti, në raportin e tij do të parashtrojë faktet përkatëse në lidhje me çështjen ndërmjet Shteteve Palë të interesuara. Parashtrimet me shkrim dhe procesverbali i parashtrimeve verbale të bëra nga Shtetet Palë në fjalë, do t'i bashkëlidhen raportit. Komiteti gjithashtu mund t'u komunikojë vetëm Shteteve Palë të interesuara çdo pikëpamje që mund ta çmojë të rëndësishme për çështjen ndërmjet tyre.

Për çdo çështje, raporti do t'u komunikohet Shteteve Palë të interesuara

2. Një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të depozitohet nga Shtetet Palë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ua transmetojë kopjet e saj Shteteve të tjera Palë. Një deklaratë mund të tërhiqet në çdo kohë me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Një tërheqje e tillë nuk do të cenojë shqyrtimin e ndonjë çështjeje që është objekt i një komunikimi tashmë të transmetuar sipas këtij neni; asnjë komunikim i mëtejshëm nga asnjë Shtet Palë nuk do të merret sipas këtij neni pasi të jetë marrë njoftimi për tërheqjen e deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm, përveç nëse shteti palë në fjalë ka bërë një deklaratë të re.

Neni 11

Procedura e hetimit

1. Një Shtet Palë në këtë protokoll mund të deklarojë në çdo kohë se njeh kompetencën e Komitetit të parashikuar në këtë nen.

2. Nëse Komiteti merr informacion të besueshëm që provon shkelje të rënda ose sistematike nga një Shtet Palë, të ndonjë prej të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të përcaktuara në Pakt, Komiteti do ta ftojë atë Shtet Palë që të bashkëpunojë në shqyrtimin e informacionit dhe për këtë qëllim të paraqesë vërejtje në lidhje me informacionin në fjalë.

3. Duke marrë parasysh çdo vëzhgim që mund të jetë paraqitur nga Shteti Palë në fjalë, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm që disponon, Komiteti mund të caktojë një ose më shumë anëtarë të tij për të kryer një hetim dhe për t'i raportuar urgjentisht Komitetit. Kur garantohet dhe me pëlqimin e Shtetit Palë, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e tij.

4. Një hetim i tillë do të kryhet në mënyrë konfidenciale dhe do të kërkohet bashkëpunimi i Shtetit Palë në të gjitha fazat e procedimit.

5. Pas shqyrtimit të gjetjeve të një hetimi të tillë, Komiteti do t'ia transmetojë këto gjetje Shtetit Palë në fjalë së bashku me çdo koment dhe rekomandim.

6. Shteti Palë në fjalë, brenda gjashtë muajve nga marrja e gjetjeve, komenteve dhe rekomandimeve të transmetuara nga Komiteti, do t'i paraqesë Komitetit vëzhgimet e tij.

7. Pasi këto procedura të kenë përfunduar në lidhje me një hetim të kryer në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti, pas konsultimeve me Shtetin Palë në fjalë, mund të vendosë të përfshijë një përmbledhje të rezultateve të procedurave në raportin vjetor të parashikuar në nenin 15 të këtij protokoll.

8. Çdo Shtet Palë që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, mund ta tërheqë këtë deklaratë në çdo kohë, me njoftim Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 12

Vazhdimi i procedurës së hetimit

1. Komiteti mund të ftojë Shtetin Palë në fjalë që të përfshijë në raportin e tij, sipas neneve 16 dhe 17 të Paktit, detaje të çdo mase të marrë në përgjigje të një hetimi të kryer sipas nenit 11 të këtij protokoll.

2. Komiteti, nëse është e nevojshme, pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të përmendur në nenin 11, paragrafi 6, mund të ftojë Shtetin Palë në fjalë që ta informojë për masat e marra në përgjigje të një hetimi të tillë.

Neni 13
Masat mbrojtëse

Një Shtet Palë do të marrë të gjitha masat e duhura për të garantuar që individët nën juridiksionin e tij të mos i nënshtrohen asnjë forme keqtrajtimi ose frikësimi si pasojë e komunikimit me Komitetin në përputhje me këtë protokoll.

Neni 14
Ndihma dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Komiteti do t'u transmetojë, siç mund ta çmojë të përshtatshme, dhe me pëlqimin e Shtetit Palë në fjalë, agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara, fondeve dhe programeve dhe organeve të tjera kompetente, pikëpamjet ose rekomandimet e tij në lidhje me komunikimet dhe hetimet që shprehin nevojën për këshilla ose asistencë teknike, së bashku me vëzhgimet dhe sugjerimet e Shtetit Palë, nëse ka, mbi këto pikëpamje ose rekomandime.

2. Komiteti gjithashtu mund t'u sjellë në vëmendje organeve të tilla, me pëlqimin e Shtetit Palë në fjalë, çdo çështje që lind nga komunikimet e shqyrtuara sipas këtij protokoll, e cila mund t'i ndihmojë të vendosin, secili brenda fushës së tij të kompetencës, mbi këshillueshmërinë e masave ndërkombëtare që mund të kontribuojnë për të ndihmuar Shtetet Palë në arritjen e përparimit në zbatimin e të drejtave të njohura në Pakt.

3. Një fond besimi do të krijohet në përputhje me procedurat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme që do të administrohet në përputhje me rregulloret financiare dhe rregullat e Kombeve të Bashkuara, me synimin për t'u ofruar ndihmë ekspertize dhe teknike Shteteve Palë, me pëlqimin e Shtetit Palë në fjalë, për zbatimin e zgjeruar të të drejtave të përfshira në Pakt, duke kontribuar kështu në ndërtimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në kontekstin e këtij protokoll.

4. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë detyrimet e ndonjë shteti palë për të përmbushur detyrimet e tij sipas Paktit.

Neni 15
Raporti vjetor

Komiteti do të përfshijë në raportin e tij vjetor një përmbledhje të aktiviteteve të tij sipas këtij protokoll.

Neni 16
Përhapja dhe informacioni

Çdo Shtet Palë merr përsipër të bëjë të njohur gjerësisht dhe shpërndajë Paktin dhe këtë protokoll dhe të lehtësojë aksesin në informacion në lidhje me pikëpamjet dhe rekomandimet e Komitetit, në veçanti për çështjet që përfshijnë atë Shtet Palë dhe ta bëjë në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 17
Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që ka nënshkruar, ratifikuar ose aderuar në Pakt.

2. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Pakt. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky protokoll do të jetë i hapur për aderim nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Pakt.

4. Aderimi do të kryhet me depozitim të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 18
Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon në këtë protokoll, pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, protokollin do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të dokumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 19
Ndryshimet

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një ndryshim të këtij protokollin dhe t'ia paraqesë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do t'u komunikojë çdo ndryshim të propozuar Shteteve Palë, me kërkesë për t'u njoftuar nëse ata janë pro një takimi të Shteteve Palë, me qëllim të shqyrtimit dhe vendosjes mbi propozimet. Në rast se brenda katër muajve nga data e një komunikimi të tillë, të paktën një e treta e Shteteve Palë janë pro një takimi të tillë, Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë mbledhjen nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga shumica e dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe votuese do t'i paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm Asamblesë së Përgjithshme për miratim dhe më pas të gjitha Shteteve Palë për pranim.

2. Një ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pasi numri i instrumenteve të depozituara të pranimit, të arrijë dy të tretat e numrit të Shteteve Palë në datën e miratimit të ndryshimit. Më pas, ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo Shtet Palë në ditën e tridhjetë pas depozitimit të dokumentit të tij të pranimit. Një ndryshim do të jetë i detyrueshëm vetëm për ato Shtete Palë që e kanë pranuar atë.

Neni 20
Denoncimi

1. Çdo Shtet Palë mund të denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi nuk do të cenojë zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të këtij protokollin për çdo komunikim të paraqitur sipas neneve 2 dhe 10 ose për çdo procedurë të nisur sipas nenit 11 përpara datës së hyrjes në fuqi të denoncimit.

Neni 21
Njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë të gjitha shtetet e përmendura në nenin 26, paragrafi 1, të Paktit për të dhënat e mëposhtme:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas këtij protokollin;
- b) data e hyrjes në fuqi të këtij protokollin dhe të çdo ndryshimi sipas nenit 19;
- c) çdo denoncim sipas nenit 20.

Neni 22
Gjuhët zyrtare

1. Ky protokoll, tekstet e të cilit janë në arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëloj autentike, do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'u transmetojë kopje të vërtetuara të këtij protokollin të gjitha shteteve të përmendura në nenin 26 të Paktit.

The General Assembly adopted resolution A/RES/63/117, on 10 December 2008

Optional Protocol to the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights

The General Assembly,

Taking note of the adoption by the Human Rights Council, by its resolution 8/2 of 18 June 2008, of the Optional Protocol to the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights,

1. *Adopts* the Optional Protocol to the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights, the text of which is annexed to the present resolution;

2. *Recommends* that the Optional Protocol be opened for signature at a signing ceremony to be held in 2009, and requests the Secretary-General and the United Nations High Commissioner for Human Rights to provide the necessary assistance.

Annex

Optional Protocol to the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights

Preamble

The States Parties to the present Protocol,

Considering that, in accordance with the principles proclaimed in the Charter of the United Nations, recognition of the inherent dignity and of the equal and inalienable rights of all members of the human family is the foundation of freedom, justice and peace in the world,

Noting that the Universal Declaration of Human Rights¹ proclaims that all human beings are born free and equal in dignity and rights and that everyone is entitled to all the rights and freedoms set forth therein, without distinction of any kind, such as race, colour, sex, language, religion, political or other opinion, national or social origin, property, birth or other status,

Recalling that the Universal Declaration of Human Rights and the International Covenants on Human Rights² recognize that the ideal of free human beings enjoying freedom from fear and want can only be achieved if conditions are created whereby everyone may enjoy civil, cultural, economic, political and social rights,

Reaffirming the universality, indivisibility, interdependence and interrelatedness of all human rights and fundamental freedoms,

Recalling that each State Party to the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights (hereinafter referred to as the Covenant) undertakes to take steps, individually and through international assistance and cooperation,

¹ Resolution 217 A (III).

² Resolution 2200 A (XXI), annex.

especially economic and technical, to the maximum of its available resources, with a view to achieving progressively the full realization of the rights recognized in the Covenant by all appropriate means, including particularly the adoption of legislative measures,

Considering that, in order further to achieve the purposes of the Covenant and the implementation of its provisions, it would be appropriate to enable the Committee on Economic, Social and Cultural Rights (hereinafter referred to as the Committee) to carry out the functions provided for in the present Protocol,

Have agreed as follows:

Article 1

Competence of the Committee to receive and consider communications

1. A State Party to the Covenant that becomes a Party to the present Protocol recognizes the competence of the Committee to receive and consider communications as provided for by the provisions of the present Protocol.
2. No communication shall be received by the Committee if it concerns a State Party to the Covenant which is not a Party to the present Protocol.

Article 2

Communications

Communications may be submitted by or on behalf of individuals or groups of individuals, under the jurisdiction of a State Party, claiming to be victims of a violation of any of the economic, social and cultural rights set forth in the Covenant by that State Party. Where a communication is submitted on behalf of individuals or groups of individuals, this shall be with their consent unless the author can justify acting on their behalf without such consent.

Article 3

Admissibility

1. The Committee shall not consider a communication unless it has ascertained that all available domestic remedies have been exhausted. This shall not be the rule where the application of such remedies is unreasonably prolonged.
2. The Committee shall declare a communication inadmissible when:
 - (a) It is not submitted within one year after the exhaustion of domestic remedies, except in cases where the author can demonstrate that it had not been possible to submit the communication within that time limit;
 - (b) The facts that are the subject of the communication occurred prior to the entry into force of the present Protocol for the State Party concerned unless those facts continued after that date;
 - (c) The same matter has already been examined by the Committee or has been or is being examined under another procedure of international investigation or settlement;
 - (d) It is incompatible with the provisions of the Covenant;

- (e) It is manifestly ill-founded, not sufficiently substantiated or exclusively based on reports disseminated by mass media;
- (f) It is an abuse of the right to submit a communication; or when
- (g) It is anonymous or not in writing.

Article 4

Communications not revealing a clear disadvantage

The Committee may, if necessary, decline to consider a communication where it does not reveal that the author has suffered a clear disadvantage, unless the Committee considers that the communication raises a serious issue of general importance.

Article 5

Interim measures

1. At any time after the receipt of a communication and before a determination on the merits has been reached, the Committee may transmit to the State Party concerned for its urgent consideration a request that the State Party take such interim measures as may be necessary in exceptional circumstances to avoid possible irreparable damage to the victim or victims of the alleged violations.
2. Where the Committee exercises its discretion under paragraph 1 of the present article, this does not imply a determination on admissibility or on the merits of the communication.

Article 6

Transmission of the communication

1. Unless the Committee considers a communication inadmissible without reference to the State Party concerned, the Committee shall bring any communication submitted to it under the present Protocol confidentially to the attention of the State Party concerned.
2. Within six months, the receiving State Party shall submit to the Committee written explanations or statements clarifying the matter and the remedy, if any, that may have been provided by that State Party.

Article 7

Friendly settlement

1. The Committee shall make available its good offices to the parties concerned with a view to reaching a friendly settlement of the matter on the basis of the respect for the obligations set forth in the Covenant.
2. An agreement on a friendly settlement closes consideration of the communication under the present Protocol.

Article 8

Examination of communications

1. The Committee shall examine communications received under article 2 of the present Protocol in the light of all documentation submitted to it, provided that this documentation is transmitted to the parties concerned.
2. The Committee shall hold closed meetings when examining communications under the present Protocol.
3. When examining a communication under the present Protocol, the Committee may consult, as appropriate, relevant documentation emanating from other United Nations bodies, specialized agencies, funds, programmes and mechanisms, and other international organizations, including from regional human rights systems, and any observations or comments by the State Party concerned.
4. When examining communications under the present Protocol, the Committee shall consider the reasonableness of the steps taken by the State Party in accordance with part II of the Covenant. In doing so, the Committee shall bear in mind that the State Party may adopt a range of possible policy measures for the implementation of the rights set forth in the Covenant.

Article 9

Follow-up to the views of the Committee

1. After examining a communication, the Committee shall transmit its views on the communication, together with its recommendations, if any, to the parties concerned.
2. The State Party shall give due consideration to the views of the Committee, together with its recommendations, if any, and shall submit to the Committee, within six months, a written response, including information on any action taken in the light of the views and recommendations of the Committee.
3. The Committee may invite the State Party to submit further information about any measures the State Party has taken in response to its views or recommendations, if any, including as deemed appropriate by the Committee, in the State Party's subsequent reports under articles 16 and 17 of the Covenant.

Article 10

Inter-State communications

1. A State Party to the present Protocol may at any time declare under the present article that it recognizes the competence of the Committee to receive and consider communications to the effect that a State Party claims that another State Party is not fulfilling its obligations under the Covenant. Communications under the present article may be received and considered only if submitted by a State Party that has made a declaration recognizing in regard to itself the competence of the Committee. No communication shall be received by the Committee if it concerns a State Party which has not made such a declaration. Communications received under the present article shall be dealt with in accordance with the following procedure:

(a) If a State Party to the present Protocol considers that another State Party is not fulfilling its obligations under the Covenant, it may, by written communication, bring the matter to the attention of that State Party. The State Party

may also inform the Committee of the matter. Within three months after the receipt of the communication the receiving State shall afford the State that sent the communication an explanation, or any other statement in writing clarifying the matter, which should include, to the extent possible and pertinent, reference to domestic procedures and remedies taken, pending or available in the matter;

(b) If the matter is not settled to the satisfaction of both States Parties concerned within six months after the receipt by the receiving State of the initial communication, either State shall have the right to refer the matter to the Committee, by notice given to the Committee and to the other State;

(c) The Committee shall deal with a matter referred to it only after it has ascertained that all available domestic remedies have been invoked and exhausted in the matter. This shall not be the rule where the application of the remedies is unreasonably prolonged;

(d) Subject to the provisions of subparagraph (c) of the present paragraph the Committee shall make available its good offices to the States Parties concerned with a view to a friendly solution of the matter on the basis of the respect for the obligations set forth in the Covenant;

(e) The Committee shall hold closed meetings when examining communications under the present article;

(f) In any matter referred to it in accordance with subparagraph (b) of the present paragraph, the Committee may call upon the States Parties concerned, referred to in subparagraph (b), to supply any relevant information;

(g) The States Parties concerned, referred to in subparagraph (b) of the present paragraph, shall have the right to be represented when the matter is being considered by the Committee and to make submissions orally and/or in writing;

(h) The Committee shall, with all due expediency after the date of receipt of notice under subparagraph (b) of the present paragraph, submit a report, as follows:

(i) If a solution within the terms of subparagraph (d) of the present paragraph is reached, the Committee shall confine its report to a brief statement of the facts and of the solution reached;

(ii) If a solution within the terms of subparagraph (d) is not reached, the Committee shall, in its report, set forth the relevant facts concerning the issue between the States Parties concerned. The written submissions and record of the oral submissions made by the States Parties concerned shall be attached to the report. The Committee may also communicate only to the States Parties concerned any views that it may consider relevant to the issue between them.

In every matter, the report shall be communicated to the States Parties concerned.

2. A declaration under paragraph 1 of the present article shall be deposited by the States Parties with the Secretary-General of the United Nations, who shall transmit copies thereof to the other States Parties. A declaration may be withdrawn at any time by notification to the Secretary-General. Such a withdrawal shall not prejudice the consideration of any matter that is the subject of a communication already transmitted under the present article; no further communication by any State Party shall be received under the present article after the notification of withdrawal of the

declaration has been received by the Secretary-General, unless the State Party concerned has made a new declaration.

Article 11

Inquiry procedure

1. A State Party to the present Protocol may at any time declare that it recognizes the competence of the Committee provided for under the present article.
2. If the Committee receives reliable information indicating grave or systematic violations by a State Party of any of the economic, social and cultural rights set forth in the Covenant, the Committee shall invite that State Party to cooperate in the examination of the information and to this end to submit observations with regard to the information concerned.
3. Taking into account any observations that may have been submitted by the State Party concerned as well as any other reliable information available to it, the Committee may designate one or more of its members to conduct an inquiry and to report urgently to the Committee. Where warranted and with the consent of the State Party, the inquiry may include a visit to its territory.
4. Such an inquiry shall be conducted confidentially and the cooperation of the State Party shall be sought at all stages of the proceedings.
5. After examining the findings of such an inquiry, the Committee shall transmit these findings to the State Party concerned together with any comments and recommendations.
6. The State Party concerned shall, within six months of receiving the findings, comments and recommendations transmitted by the Committee, submit its observations to the Committee.
7. After such proceedings have been completed with regard to an inquiry made in accordance with paragraph 2 of the present article, the Committee may, after consultations with the State Party concerned, decide to include a summary account of the results of the proceedings in its annual report provided for in article 15 of the present Protocol.
8. Any State Party having made a declaration in accordance with paragraph 1 of the present article may, at any time, withdraw this declaration by notification to the Secretary-General.

Article 12

Follow-up to the inquiry procedure

1. The Committee may invite the State Party concerned to include in its report under articles 16 and 17 of the Covenant details of any measures taken in response to an inquiry conducted under article 11 of the present Protocol.
2. The Committee may, if necessary, after the end of the period of six months referred to in article 11, paragraph 6, invite the State Party concerned to inform it of the measures taken in response to such an inquiry.

Article 13

Protection measures

A State Party shall take all appropriate measures to ensure that individuals under its jurisdiction are not subjected to any form of ill-treatment or intimidation as a consequence of communicating with the Committee pursuant to the present Protocol.

Article 14

International assistance and cooperation

1. The Committee shall transmit, as it may consider appropriate, and with the consent of the State Party concerned, to United Nations specialized agencies, funds and programmes and other competent bodies, its views or recommendations concerning communications and inquiries that indicate a need for technical advice or assistance, along with the State Party's observations and suggestions, if any, on these views or recommendations.

2. The Committee may also bring to the attention of such bodies, with the consent of the State Party concerned, any matter arising out of communications considered under the present Protocol which may assist them in deciding, each within its field of competence, on the advisability of international measures likely to contribute to assisting States Parties in achieving progress in implementation of the rights recognized in the Covenant.

3. A trust fund shall be established in accordance with the relevant procedures of the General Assembly, to be administered in accordance with the financial regulations and rules of the United Nations, with a view to providing expert and technical assistance to States Parties, with the consent of the State Party concerned, for the enhanced implementation of the rights contained in the Covenant, thus contributing to building national capacities in the area of economic, social and cultural rights in the context of the present Protocol.

4. The provisions of the present article are without prejudice to the obligations of each State Party to fulfil its obligations under the Covenant.

Article 15

Annual report

The Committee shall include in its annual report a summary of its activities under the present Protocol.

Article 16

Dissemination and information

Each State Party undertakes to make widely known and to disseminate the Covenant and the present Protocol and to facilitate access to information about the views and recommendations of the Committee, in particular, on matters involving that State Party, and to do so in accessible formats for persons with disabilities.

Article 17

Signature, ratification and accession

1. The present Protocol is open for signature by any State that has signed, ratified or acceded to the Covenant.
2. The present Protocol is subject to ratification by any State that has ratified or acceded to the Covenant. Instruments of ratification shall be deposited with the Secretary-General of the United Nations.
3. The present Protocol shall be open to accession by any State that has ratified or acceded to the Covenant.
4. Accession shall be effected by the deposit of an instrument of accession with the Secretary-General of the United Nations.

Article 18

Entry into force

1. The present Protocol shall enter into force three months after the date of the deposit with the Secretary-General of the United Nations of the tenth instrument of ratification or accession.
2. For each State ratifying or acceding to the present Protocol, after the deposit of the tenth instrument of ratification or accession, the Protocol shall enter into force three months after the date of the deposit of its instrument of ratification or accession.

Article 19

Amendments

1. Any State Party may propose an amendment to the present Protocol and submit it to the Secretary-General of the United Nations. The Secretary-General shall communicate any proposed amendments to States Parties, with a request to be notified whether they favour a meeting of States Parties for the purpose of considering and deciding upon the proposals. In the event that, within four months from the date of such communication, at least one third of the States Parties favour such a meeting, the Secretary-General shall convene the meeting under the auspices of the United Nations. Any amendment adopted by a majority of two thirds of the States Parties present and voting shall be submitted by the Secretary-General to the General Assembly for approval and thereafter to all States Parties for acceptance.
2. An amendment adopted and approved in accordance with paragraph 1 of the present article shall enter into force on the thirtieth day after the number of instruments of acceptance deposited reaches two thirds of the number of States Parties at the date of adoption of the amendment. Thereafter, the amendment shall enter into force for any State Party on the thirtieth day following the deposit of its own instrument of acceptance. An amendment shall be binding only on those States Parties which have accepted it.

Article 20

Denunciation

1. Any State Party may denounce the present Protocol at any time by written notification addressed to the Secretary-General of the United Nations. Denunciation

shall take effect six months after the date of receipt of the notification by the Secretary-General.

2. Denunciation shall be without prejudice to the continued application of the provisions of the present Protocol to any communication submitted under articles 2 and 10 or to any procedure initiated under article 11 before the effective date of denunciation.

Article 21

Notification by the Secretary-General

The Secretary-General of the United Nations shall notify all States referred to in article 26, paragraph 1, of the Covenant of the following particulars:

- (a) Signatures, ratifications and accessions under the present Protocol;
- (b) The date of entry into force of the present Protocol and of any amendment under article 19;
- (c) Any denunciation under article 20.

Article 22

Official languages

1. The present Protocol, of which the Arabic, Chinese, English, French, Russian and Spanish texts are equally authentic, shall be deposited in the archives of the United Nations.

2. The Secretary-General of the United Nations shall transmit certified copies of the present Protocol to all States referred to in article 26 of the Covenant.